

V E N D I M
Nr.609, datë 31.12.1993

PËR NDRYSHIMIN E ÇMIMIT TË NAFTËS DHE TË NËNPRODUKTEVE TË SAJ

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Çmimi i shitjes të naftës bruto caktohet 6300 lekë për ton. Çmimi i shitjes i gazit natyror dhe shoqërues caktohet 6300 lekë për 1000/m³.

2. Çmimet e reja të shitjes me pakicë të nënprodukteve kryesore të naftës caktohen sipas listës që i bashkëngjitet këtij vendimi. Këto çmime janë të detyrueshme për të gjitha subjektet shtetërore e private që i tregtojnë ato.

Çmimet e nënprodukteve të tjera të naftës që nuk përfshihen në këtë listë, liberalizohen.

3. Për benzinën e importuar të gjitha subjektet shtetërore e private detyrohen të derdhin në buxhetin e shtetit, përveç akcizës dhe taksës doganore, edhe një diferencë çmimi në masën që vijon:

		Litër	Lekë për: kg
- Benzinë RON 70-85	.2	2.7	
- Benzinë RON 85.1-95	5	6.8	
- Benzinë RON 95.1 e lart	10	13.5	
- Benzinë pa plumb.....	8	10.8	

Këto diferenca arkëtohen nga organet doganore në të njëjtën kohë me arkëtimin e akcizës dhe taksës doganore. Subjektet private, për benzinë e importuar, në doganë do të paguajnë edhe taksën e qarkullimit rrugor. Kur këto subjekte ua shesin benzinën e importuar distributorëve (shtetërorë ose privatë), paraqesin dokumentacionin e rregullt në degën e tatimeve të rrethit për të rimbursuar taksën e qarkullimit rrugor, të cilën e paguan blerësi i ri. Taksa e qarkullimit rrugor dhe rimbursimi të zbatohet në të njëjtën mënyrë edhe për gazoilin që importohet nga subjektet private.

4. Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave) cakton çmimet dysHEME për importimin e karburanteve e të nënprodukteve të tjera kryesore të naftës.

5. Ministria e financave dhe Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike caktojnë çmimet e shitjes në valutë të karburanteve e lubrifikanteve për anijet dhe avionet e huaj që furnizohen në portet dhe aeroportete Republikës së Shqipërisë.

6. Çdo akt tjetër nënligjor që bie në kundërshtim me këtë vendi, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi më 16 janar 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

ÇMIMET E SHITJES ME PAKICË TË NËNPRODUKTEVE
KRYESORE TË NAFTËS

Nr. E m ë r t i m i Njësia e matjes Çmimi i shitjes me pakicë

Lekë

1	Benzinë :		
	- RON 70-85litër		46
	- RON 85.1 - 95 “	65	
	- RON 95.1 e lart “	82	
	- Benzinë pa plumb “		80
2	Gazoil “		38
3	Vajguri :		
	- Për përdoruesit jofamiljarë “		38
	- Vajguri TS-1 “	23	
4	Gaz i lëngshëm kg		19